



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

Nr. Regj. Them.: 3256/ 496/ 2076

Nr. i Vendimit: 1739

Datë Regjistrimi: 10.12.2021/02.06.2022

Data e Vendimit: 28.06.2022

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga:

GJYQTAR:ARTAN GJERMËNI

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Ornela BALLA**, në Tiranë, sot më datë **28.06.2022**, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen penale **Nr. 3256/496/2076 Regj. Them.**, që i përket:

KËRKUES:Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga prokurori Bledar Valikaj.

I PANDEHUR:Indrit Lloçi -i biri i Muharrem dhe i Xhevrije, i datëlindjes 18.05.1990, lindur dhe banues në Tiranë, me adresë: Sauk, Njësia Administrative nr.2,i martuar, me arsim 7-klasë, i padënuar më parë,me shtetësi dhe kombësi shqiptare,i identifikuar me kartën e ID me Nr.J00518050L, i hetuar me masë sigurimi “Arrest në shtëpi”, mbrojtur nga avokatia e zgjedhur Lirime Çukaj, anëtare e Dhomës së Avokatisë Tiranë.

AKUZUAR:Për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal.

Në përfundim të gjykimit,Gjykata pasi shqyrtoi në tërësi rrethanat e çështjes dhe çmoi dhe vlerësoi në tërësi provat e marra në seancë gjyqësore nënshtruar rregullave të gjykimit të shkurtuar, dëgjoji konkluzionet përfundimtare të prokurorit, të të pandehurit dhe avokatit të tij, të cilët përkatësisht kërkuan:

Prokurori:- Deklarimin fajtor të të pandehurit Indrit Lloçi për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 4 (katër) vjet burgim. – Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, dënimin e tij përfundimtar me 2 (dy) vjet e 8 (tetë) muaj burgim.

Avokate Lirime Çukaj: - Bazuar në nenin 388/1/d të K.Pr.Penale, kërkojmë deklarin e pafajshëm të të pandehurit Indrit Lloçi. – Në rast se gjykata e cmon fajtor, kërkojmë aplikimin e dënimit alternativ “Pezullimi i ekzekutimit të dënimit dhe vënia në provë”, sipas nenit 59 të Kodit Penal, për pjesën e mbetur të dënimit.

I pandehuri Indrit Lloçi:- Dakord me avokatin.

VËREN:

PROCEDURA

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur pranë kësaj Gjykate kërkesën për dërgimin në gjyq të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit Indrit Lloçi, i akuzuar për kryerjen e veprës penale "Kultivimi i bimëve narkotike" të parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal.

Më datë 02.06.2022 në seancë paraprake, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij paraqitën kërkesë për gjykim të shkurtuar.

Pasi shqyrtoi në tërësi aktet dhe fashikullin e hetimeve paraprake, Gjykata çmoi se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet dhe për rrjedhojë, në përputhje me nenet 332/dh, pika 1 gërma "c" dhe 403 e vijues të KPP, ftoi palët në diskutime përfundimtare, sipas procedurës së gjyimit të shkurtuar.

Në mbështetje të dispozitave të posaçme procedurale si dhe të Vendimit Unifikues Nr.2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara, ky lloj gjykimi i posaçëm eviton marrjen e provave në seancë gjyqësore dhe debatin lidhur me to. Në këto kushte fashikulli (dosja) e prokurorit kthehet në dosje gjyqësore duke marrë vlerën e provës pas pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar. Në këtë fashikull bazohen diskutimet përfundimtare të palëve si dhe gjykata në dhënien e vendimit.

Palët paraqitën diskutimet përfundimtare, sic përcaktohet në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

RRETHANAT E ÇËSHTJES

Më datë 17.09.2021 rreth orës 07.45 është kapur në flagrancë në një parcelë me bimë të dyshuar si cannabis sativa shtetasi Indrit Lloçi, ngjarje e ndodhur në fshatin Shpat-Rrovë, Njësia Administrative Baldushk, Tiranë.

Nga ana e punonjësve të Postës së Policisë Farkë u mbajt Raport Shërbimi datë 17.09.2021, nga ku rezulton se këta punonjës ishin të planifikuar grup kontrolli me plan masash në fshatin Shpatë, Njësia Administrative Bladushk. Rreth orës 07:45 gjatë kontrollit në malin e Shpatës u konstatuan dy parcela të vogla me bimë të kultivuara të ngjashme me bimët cannabis sativa. Hynë te parcela e parë dhe ishte një rrugë e ngushtë rreth 5-6 metra dhe dolën te parcela tjetër. Sapo dolën te parcela tjetër në krahun e djathtë të saj ishte një person me bluzë ngjyrë blu të cilit po binte telefoni. Menjëherë i kanë thërritur "Ndal Policia" dhe janë afruar drejtë tij. Gjatë prangosjes u bë mundur identifikimi i shtetasit Indrit Lloçi datëlindjes 18.05.1990.

Rruga të çonte tek një gropë e cila ishte krijuar për të bledhur ujin me të cilën gjendej një tub, i cili çonte ujin në parcelat ku ishte kultivuar lënda narkotike.

Në këto kushte, nga ana e punonjësve të Postës së Policisë Farkë u mbajt Procesverbal i kapjes në flagrancë shtetasit Indrit Lloçi.

Nga ana e policisë gjyqësore u mbajt procesverbal për kqyrjen e vendit të ngjarjes. Nga përmbajtja e këtij procesverbali rezulton se vendi i ngjarjes ndodhet në Njësin

Administrative Baldushk, fshati Shpat-Rrove. Objekt kqyrje është një gastër e mbjellë me bimë të dyshuar si ato të bimës cannabis sativa. Kjo ngaster toke kufizohet me bimësi të gjelbër, të dendur, shkurre dhe bimësi mare që shkojnë nga lartësi deri në rreth 5 metra.

Kjo ngastër kufizohet nga të gjitha krahët në pyll. Kjo ngastër është me përmasa 12x17 metra dhe të mbjella aty vërehen 40 copë bimë si ato narkotike cannabis sativa. Këto bimë janë me sistem rrënjor të futura në gropa me përmasa 60x70 cm. Pjesa mbi tokë e bimëve është e gjelbër që shkon nga 1.3 metër deri 2.2 meter. Me pjesë përbërëse të bimës me kërcell, gjethe dhe lulesa si ato të bimëve cannabis sativa. Në anën veri-lindore vihet re tubacion plastik me ngjyrë të zezë i cili shtrihet në drejtim të një pusi (grop e veshur me plasmas në të gjitha anët me sipërfaqe 3x2.2 metra katrorë). Nga pusi zgjatohet tubacioni me ngjyrë të zezë në drejtim të ngastrës së lart përshkuar. Në anën jug-perëndimore gjendet një bidon plastik me të kuqe me tap të zezë me mbetje pluhuri në të gjithë sipërfaqen e saj. Nga kjo parcelë nëpërmjet një shtegu të hapur në bimësinë e dendur në shkurre prej 7 metrash bëhet kalimi për në ngastrën tjetër, ku edhe kjo ngastër gjendet e mbjellë me bimë si ato narkotike cannabis sativa. Ngastra është me përmasa 18x5 metra. Në këtë ngaster vihet re këto bimë të ngjashme si ato narkotike cannabis sativa ku gjenden 22 copë në lartësi nga 1 meter deri në 2 metra. Bimët vihen re me sistem rrënjor të ngulura me përmasa të gropës 70x90 cm. Mbi tokë bimët kanë kërcell, the si dhe lulesa ngjyrë të gjelbër si ato të bimëve narkotike cannabis sativa. Nga ana që përkon me majën e kodrës vihet re një shteg rruge që të nxjerr te gropa ujëmbledhëse e veshur me plasmas të zi me përmasa 6x2.3 metra dhe thellësi 1.7 metra ku në fundin e secilit ka asi uji deri në lartësinë 50 centimetra. Nga ky pus zgjatet një tub i zi me gjatësi 12 metra deri në gastrën e tokës. Në anën perëndimore te ngastres në distancën 70 cm nga gropa anësore e parcelës mbi copa shkurresh dhe mbetjesh bimore të thata vërehen dy gota plastike cilat u evindetuan me tabelën nr 1 dhe u paketuan me zarf letre sipas standartit përkatës për ekzaminime të mëtejshme laboratorike. Gjatë kqyrjes bimët e sipërcituara u prenë prej të cilave 5 copë u morën për ekzaminime të mëtejshme dhe të tjerat u asgjësuan në zjarr.

U mbajt procesverbal për asgjësimin e provës materiale lëndë e dyshuar narkotike kanabis sativa. U përpilua vendim për kryerjen e ekspertimit kimik të bimës së sekuestruar. U përpilua vendim për kryerjen e ekspertimit daktiloskopik vlerësues. U mbajt procesverbal për kontrollin e banesës së shtetasit Ingrid Lloçi ku u gjet një radio ngjyrë e zezë "Motorola" me numër serial 018TMCK411 me bateri dhe karikues. U mbajt procesverbal për sekuestrimin e Radios "motorola".

Është mbajtur procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën shtetasi Sherif Lloçi, i cili ka deklaruar se është me detyrë kryeplak I fshatit Shpat-Rrovë. Në datë 17.09.2021 e njoftoi inspektori I rendit që të paraqitej te Posta e Policisë Farkë. Ai thotë se ka marrë takim para dy ditësh me inspektorin e rendit dhe I ka shpjeguar se i dukej si zonë e dyshimtë dhe kishte lëvizje të personave që ai nga larg nuk I dallonte dot. Ai nuk hyri dot në atë zonë pasi familjet që rrinë aty pranë janë në hasmëri me të. Aty rrinë familja e shtetasit Muharrem Lloçit me djemtë e tij, familja e shtetasit Enver Lloçi me djemt e tij, Qamil Lloçi me djemtë e tij. Aty banojnë dhe personat që ai është në hasmëri si familjet e shtetasve Bashkim, Bajram dhe Sejdin Lloçi dhe për atë arsye ai nuk ka shkuar të kontrolloj në atë zonë dhe vuri në dijeni Inspektorin e zonës. Ai nuk e di tamam se kush mund ti ketë mbjellë pasi nuk e ka parë se kush I ka mbjellë, por lëvizje të dyshimta ka vënë re nga djemtë e Muharrem Lloçit dhe Qamil Lloçit. Më shpesh ka parë të lëvizti aty vërdall shtetasin Agim Lloçi I biri I Qamilit dhe Indrit Lloçi djali I Muharremit. Ai thotë se nuk I ka fiksuar të kenë pasur ndonjë gjë në dorë.

Është mbajtur procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën shtetasi Sabian Lloçi i cili ka deklaruar se ai nuk ka asnjë lloj dijenie se kush mund ti ketë mbjellë ato bimë. Ai as nuk e ka parë ndonjëherë atë lloj bime dhe as nuk e njeh. Ai Indritin e ka xhaxha. Ai thotë se Indriti rri në Sauk, ndërsa Sabiani rri në fshatin Shpat dhe nuk takohet shpesh vec rasteve kur ai shkon në fshat mund të takohen. Ai thotë se Agimin babai i tij e ka cun xhaje dhe cun teze. Me Agimin janë afër me shtëpi por nuk bëhen shumë pasi shpesh herë kanë pasur debate si familje. Ai thotë se nuk ka parë njeri te ai vend. Ai zakonisht punon në bujqësi dhe ndërtim. Në datë 17.09.2021 ka qënë duke vjelë rrush, ka shkuar rreth orës 07:30 dhe pasi voli ca rrush u kthye në shtëpi aty ku e gjeti dhe policia kur shkoi. Ai thotë se Indriti nuk shkon shpesh në fshat dhe kur shkon qëndron te shtëpia e tij.

Është mbajtur procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën shtetasi Agim Lloçi i cili ka deklaruar se në datë 17.09.2021 e ka njoftuar shefi I zonë Gazi që të paraqitet në Polici në Lundër. Ai sa kishte arrit në shtëpi se I çoi ilacet nusës. Menjëherë erdhi në Postën e policisë Farkë. Në lidhje me bimët që po i themi ai thotë se nuk ka dijeni fare. Ai thotë se nuk e di se ku janë gjetur bimët, nuk ka qënë asnjëherë dhe se ka idenë se I kujt është trualli. Ai thotë se nuk ka asnjë lloj dijenie se kush mund ti ketë mbjellur ato bimë. Ai thotë se ai numër tjetër përdor nr 0682410991. Ai thotë se Indritin e ka çun xhaxhai dhe çun teze. Me Indritin takohet ndonjëherë kur shkon në fshat për të pirë kafe ose kur shkon te vreshta. Indriti ka pas punuar me ndërtim. Ai ka nja dy dylm vresht e cila ndodhet në malin pran shkëmbit të Korbit. Ai thotë se Indriti atë muaj ka shkuar nja 5-6 herë që e ka parë ai dhe që ka pirë kafe në fshat. Sa herë që ka shkuar i ka thënë që ka shkuar me pa plakën dhe me punu te vreshti. Ai jeton afër shkollës së Policisë në sauq.

Është mbajtur procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime shtetasi Indrit Lloçi, i cili ka deklaruar se në lidhje me pyetjen e dëgjoi e kuptoi dhe do të thotë se ai ka një vresht rreth tre dylm në mal mbi fshatin Shpat. Aty ka edhe një parcelë me ullinj. Ato janë toka të trashëguara nga gjyshi por nuk kanë dokumenta. Në

datë 15.09.2021 dhe 16.09.2021 ka qënë te vreshti duke vjelë rrush dhe ja ka shitur shtetasit Hyqmet Ahmeti. Në datë 17.09.2021 u ngrit nga gjumi dhe i hypi motorrit, shkoi te vreshti ngarkoi makinën me rrush bashkë me Sabjan Lloçin, me djalin e tij të mitur 4 vjeç. Sabjani mori dy gomerë dhe iku rrugës lart për shtëpi bashkë me djalin e tij. Ndërsa Indriti iku rrugës poshtë dhe aty ka dëgjuar një zhurmë në pyll dhe nuk e dinte se kush ishte. Aty ka folur "ça ka, kush është" dhe aty i kanë thënë "policia mos lëviz se e kapëm". Ata i lidhën duart me lidhëse këpuçësh dhe i thanë "hajde me ne te parcela". Kanë shkuar te parcela dhe ishte një parcel me hashash në mes të pyllit. Gjë tjetër nuk i kanë thënë. Ai thotë se nuk ka kaluar dhe nuk ka parë bimë narkotike të mbjella në atë vend. Ai thotë se mesa di ai nuk e shfrytëzon asnjë atë tokë. Ai thotë se nuk ka parë asnjë person në atë pyll. Ai thotë se këtë muaj ka qënë rreth 10 herë te vreshti ndërsa në muajin gusht nuk e mban mend. Ai thotë se te vreshti e ka ndihmuar nusja, djali i vëllait Sabjani, dhe nëna e tij.

Nga akti i ekspertimit kimik ka rezultuar se bimët objekt ekspertimi janë bime Cannabis Sattiva L.

Nga deklaratimet e punonjësve të policisë Amarildo Kupi, Shpetim Gabi, Dritan Dedja, Gazmend Spahiu, Afrim Harizi, Artan Hasanaj rezulton se në vendngjarje nuk kishte ndonje parcele tjetër apo rruge kalimi për ndonje parcele tjetër, e cila të konfirmojë ndonje pretendim të shtetasit Indrit Lloçi. Konfirmohet fakti që Indrit Lloçi është gjendur në mes të parcelave me bime narkotike, afer gropes se ujit të mbuluar me plastmas si Indrit Lloçi. Po kështu rezulton se menjehere sapo policia i ka bërë thirrje të ndalonte, i pandehuri Indrit Lloçi iku me vrap duke bërë që forcat e policisë ta ndiqnin dhe ta ndalonin me tutje.

Nisur nga sa me sipër, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë pretendon se shtetasi Indrit Lloçi ka konsumuar veprën penale "Kultivimi i bimeve narkotike", të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal. Sipas Prokurorisë, aktet e administruara krijojnë bindjen e asryeshme se i pandehuri e ka konsumuar veprën penale për të cilën akuzohet. Pas komunikimit të akuzës dhe përfundimit të hetimeve, Prokuroria ka paraqitur kërkesë për dërgimin në gjyq të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit Indrit Lloçi.

I pandehuri Indrit Lloçi nëpërmjet mbrojtëses së tij ka pretenduar në konkluzione përfundimtare se nuk provohet sipas standardit "te j cdo dyshimi të arsyeshëm" se ai e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, prandaj Gjykata duhet ta deklarojë atë të pafajshëm. Megjithatë, i pandehuri pretendon se nëse Gjykata cmon në fajësinë e tij, ndaj tij duhet të aplikohet pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim, pasi plotësohen kushtet e nenit 59 të Kodit Penal.

VLERËSIMI I GJYKATËS

Gjykata vëren se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka ngritur akuzë penale në ngarkim të të pandehurit Indrit Lloçi për kryerjen e veprës penale "Kultivimi i bimeve narkotike", parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal.

Gjykata, pasi shqyrtoi në tërësi provat e marra gjatë gjykimit të zhvilluar sipas rregullave të posaçme të gjykimit të shkurtuar, krijoi bindjen se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Kryerja e veprës penale nga të pandehurit provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Për të arritur në këtë përfundim, Gjykata mban në konsideratë së pari, faktin penal, ashtu sikundër çmohet i provuar prej saj dhe së dyti, elementët e figurës së veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”.

Konkretisht, Gjykata vlerëson se gjatë gjykimit rezultoi e provuar se policia gjyqësore, në kuadër të veprimtarisë së saj kundër kultivimit të bimëve narkotike ka planifikuar një grup kontrolli me agjentë të policisë gjyqësore, punonjës të Postës së Policisë Farkë, për të ushtruar kontroll në fshatin Shpatë, Njësia Administrative Baldushk, Tiranë. Rezulton e provuar se më datë 17.09.2021, rreth orës 07:45, agjentët e policisë gjyqësore kanë ushtruar kontroll në malin e Shpatës. Gjatë këtij kontrolli janë konstatuar dy parcela të vogla në të cilat ishin kultivuar bimë narkotike të llojit Cannabis Sattiva L, fakt ky i vërtetuar në vijim të kontrollit nëpërmjet aktit të ekspertimit kimik të bimëve narkotike. Ka rezultuar e provuar se në momentin e kontrollit, agjentët e policisë gjyqësore fillimisht kanë aksesuar parcelën e parë. Kjo parcelë ka rezultuar me përmasa 12x17 metra dhe në të janë konstatuar të mbjella 40 copë bimë narkotike cannabis sattiva. Këto bimë kanë qenë me sistem rrënjor të futura në gropa me përmasa 60x70 cm. Pjesa mbi tokë e bimëve ka rezultuar e gjelbër që shkon nga 1.3 metër deri 2.2 metër.

Në vijim, agjentët e policisë gjyqësore, kanë kaluar nëpërmjet një shtegu të hapur në bimësinë e dendur në shkurre prej 7 metrash në drejtim të parcelës tjetër. Ka rezultuar e provuar se kjo parcelë/ngastër me përmasa 18x5 metra ka qenë e mbjellë me bimë narkotike të llojit Cannabis Sattiva L, konkretisht 22 copë, në lartësi nga 1 meter deri në 2 metra. Në momentin që kanë aksesuar parcelën e dytë, agjentët e policisë gjyqësore kanë konstatuar se në krahun e djathtë të saj ishte një person me bluzë ngjyrë blu të cilit po binte telefoni. Menjëherë i kanë thërritur "Ndal Policia", personi ka tentuar të largohet, por është kapur menjëherë nga agjentët e policisë. Pas kapjes është bërë identifikimi i tij dhe ka rezultuar se ishte i pandehuri Indrit Lloçi.

Vec sa më sipër, në prani të parcelave të lartpërshkruara është konstatuar një rrugë, e cila të çonte tek një gropë e krijuar për të bledhur ujin. Po ashtu është konstatuar një tub, i cili çonte ujin në parcelat ku ishte kultivuar lënda narkotike.

Pasi ka cmuar të provuara faktet e mësipërme, Gjykata vlerëson se i pandehuri Indrit Lloçi ka konsumuar plotësisht figurën e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal, pasi plotësohen njëkohësisht të gjithë elementët objektivë dhe subjektivë të kësaj figure të veprës penale. Konkretisht, lidhur me këto elementë të figurës së veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, Gjykata vëren si më poshtë vijon:

Vepra penale “Kultivimi i bimëve narkotike” është e parashikuar në nenin 284 të Kodit Penal me këtë përmbajtje:

“Kultivimi i bimëve, që shërbejnë ose dihet se shërbejnë për prodhimin dhe nxjerrjen e lëndëve narkotike dhe psikotrope, pa leje dhe autorizim sipas ligjit, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet.

Po kjo veprë, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

Organizmi, drejtimi apo financimi i kësaj veprimtarie, dënohen me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.”

Objekt i veprës penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura nga shteti për të siguruar ligjshmërinë dhe kontrollin e kultivimit dhe prodhimit të substancave narkotike dhe psikotrope për shkak të rrezikut të madh që ato paraqitin përshëndetin publik dhe domosdoshmërisë së përdorimit të tyre në rrugë të kontrolluar në mjekësi. Objekt tjetër janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar jetën dhe shëndetin e njeriut nga përdorimi abuziv i substancave narkotike e psikotrope.

Nga ana objektive vepra penale e kultivimit të bimëve narkotike kryhet me veprime aktive të kundërligjshme dhe shoqërisht të rrezikshme, që konsistojnë në mbjelljen, ujitjen, rritjen, kultivimin e bimëve narkotike dhe psikotrope të ndaluara nga legjislacioni i posacëm, sikundër është edhe bima e Cannabis Sattiva.

Koncepti ligjor i “Kultivimit” jepet nga Ligji nr.8750, datë 26.03.2001, “Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike dhe psikotrope”, ku në nenin 2, pika 3 e tij jepet përkufizimi: “Kultivim” kuptohet veprimtaria e kryer për prodhimin e bimëve që përmbajnë substanca narkotike ose psikotrope, ose që mund të përdoren për nxjerrjen e substancave narkotike ose psikotrope”.

Edhe në analizë leksikore-gjuhësore rezultuar nga fjalori shqip-shqip, por edhe nga konteksti i fjalorëve të disa shteteve anëtare të B.E-se, rezulton se fjala “kultivim” ka tekstualisht kuptimin e “punimit të një toke, terreni, etj., mbjelljen e farës së bimës ose pemës dhe kujdesin për të duke e punuar, vaditur, krasitur, korrur, etj., derisa të prodhohen frytet e duhura”.

Sikundër u parashtrua më lart në këtë vendim, Gjykata cmon se veprimet e të pandehurit Indrit Lloçi përbëjnë elementë të veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike”.

Konkretisht, ai ka kultivuar 62 bimë narkotike të llojit Cannabis Sattiva L në dy parcela të ndodhura në malin e Shpatës, në fshatin Shpatë, Njësia Administrative Baldushk, Tiranë. I

pandehuri ka punuar tokën, ka mbjellë bimën narkotike dhe është kujdesur për ujitjen e saj nëpërmjet një grope të krijuar për këtë qëllim. Pavarësisht se nuk ekzistojnë prova direkte që tregojnë kryerjen e kultivimit nga i pandehuri, Gjykata cmon se ekzistojnë indicje të atilla që provojnë tej cdo dyshimi të arsyeshëm se vepra penale është kryer nga i pandehuri Indrit Lloçi. Kështu, së pari rezulton e provuar se në fshatin Shpatë, Njësia Administrative Baldushk janë mbjellë dy parcela me bimë narkotike Cannabis Sattiva L. Rezulton e provuar se i pandehuri Indrit Lloçi është gjendur në njërin nga këto parcela.

Rezulton e provuar se i pandehuri, në momentin që është konstatuar nga agentët e policisë gjyqësore ka tentuar të largohet, por është kapur menjëherë prej tyre. Rezulton e provuar

se në afërsi të parcelave nuk gjendet ndonjë vresht me rrush, ndryshe nga sa pretendon i pandehuri në alibinë e ngritur prej tij për arsyen e vendndodhjes në malin e Shpatës. Nga ana tjetër, pretendimi i të pandehurit se ka qenë në malin e Shpatës me shtetasin Sabjan Lloci dhe djalin e tij të mitur, nuk konfirmohet nga deklaratimet e shtetasit Sabjan Lloci. Sa më sipër, Gjykata cmon se fakti penal provohet plotësisht pasi provat e lartpërmendura janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra tjetrën, duke u plotësuar kushtet e nenit 152/2 të Kodit të Procedurës Penale, që parashikon se: “2. Ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indicjet përveçse kur këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën.”. Gjykata i cmon provat e lartpërmendura në tërësinë e tyre dhe në harmoni me njëra tjetrën dhe arrin në përfundimin se i pandehuri ka kryer veprime të kundërligjshme dhe shoqërisht të rrezikshme që konsistojnë në kultivimin e bimëve narkotike.

Subjekt i veprës penale është cdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm. Për rrjedhojë, i pandehuri Indrit Lloci, duke qenë madhor dhe i përgjegjshëm është subjekt i veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike”.

Nga ana subjektive vepra penale kryhet me dashje. Në çështjen në gjykim, Gjykata cmon se i pandehuri e ka kryer veprën penale me dashje të drejtëpërdrejtë, duke u plotësuar edhe ky element subjektiv i ekzistencës së veprës penale të “Kultivimi i bimëve narkotike”.

Sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se fajësia e të pandehurit Indrit Lloci provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe në përputhje me nenin 390, pika 1 e K.Pr.Penale, gjykata duhet të japë vendim për dënimin e tij, duke caktuar llojin dhe masën e dënimit.

Lidhur me caktimin e llojit dhe masës së dënimit, gjykata mban në konsideratë nenin 47 të Kodit Penal, ku parashikohet se: “Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e përgjithshme të këtij kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuara në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit si dhe rrethanat lehtësuese e rënduese”. Sipas Kolegjeve të Bashkuara, kjo dispozitë, e marrë në tërësinë e saj, i referohet parimit të individualizimit të dënimit dhe mënyrës se si ky parim duhet respektuar nga gjykata. Parimi i individualizimit, në thelb, përmban parimin e proporcionalitetit mes veprës penale të konsumuar dhe dënimit që caktohet ndaj autorit të saj. Në bazë të jurisprudencës kushtetuese: “Gjykata Kushtetuese, duke pasur parasysh dhe doktrinën e konsoliduar evropiane në këtë fushë, konstaton se, që të jetë i pranueshëm dënimi penal në aspektin kushtetues, në përputhje me nenin 17/1 të Kushtetutës, duhet të jetë i drejtë dhe në përputhje me veprën.” (Vendimi nr. 3, datë 02.11.2015, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë)

Duke u kthyer në çështjen konkrete, gjykata mban në konsideratë se i pandehuri akuzohet për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, paragrafi i parë. Vepra penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, në paragrafin e parë parashikon një dënim me burgim nga tre deri në shtatë vjet burgim. Kjo veprë penale paraqet rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe është e përhapur gjerësisht. Për rrjedhojë ndaj saj duhet të ushtrohet edhe

një politikë penale e kujdesshme. Gjykata mban në konsideratë rrezikshmërinë shoqërore të të pandehurit, i cili është i padënuar më parë.

Në këto kushte, Gjykata çmon se i pandehuri duhet të dënohet me 3 (tre) vjet burgim. Në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale të pandehurit i ulet 1/3 e dënimit, duke u dënuar perfundimisht me 2 (dy) vjet burgim.

Veç sa më sipër, Gjykata çmon se kërkimi i të pandehurit për pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien e të pandehurit në provë është i mbështetur në ligjin penal. Gjykata sjell në vëmendje përmbajtjen e nenit 59 të Kodit Penal, i cili në pikën 1 të tij parashikon se: "1. Për shkak të rrezikshmërisë së pakte të personit, moshe's, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, vecanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë vjet, mund të urdhet rojë, që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjeter penale.".

Duke mbajtur në konsideratë kriteret e kërkuara nga neni 59 i Kodit Penal si dhe duke ju referuar rrethanave konkrete në çështjen në gjykim, gjykata çmon se ekzekutimi i vendimit të dënimit me burgim ndaj të dënuarit Indrit Lloçi duhet të pezullohet duke u vendosur ky i dënuar në provë dhe me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale dhe të mos shoqërohet me persona të dënuar. Konkretisht i pandehuri Indrit Lloçi është i padënuar më parë; ai është kryefamiljar dhe ka dy fëmijë të mitur në moshën 5 dhe 3 vjec. Bashkëshortja e tij është e papunë dhe i pandehuri është i vetmi që mund të sigurojë të ardhura për familjen. Po ashtu gjykata konstaton se i pandehuri është hetuar me masë sigurimi "Arrest në shtëpi", duke qëndruar nën efektin e kësaj mase nga data 19.09.2021 deri në ditën e shpalljes së këtij vendimi, pra për një periudhë mbi 9 muaj.

Sa i përket afatit të provës, në përputhje me pikën 3 të nenit 59 të Kodit Penal, gjykata vlerëson se i dënuari duhet të vihet në provë për një periudhë kohe prej 4 vjet. Gjatë kohës së provës, i dënuari duhet të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës të vendbanimit të tij.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 190, 383, 390, 393 të Kodit të Procedurës Penale si dhe nenit 284/1 të Kodit Penal

VENDOSI:

Të deklarojë fajtor të pandehurin Indrit Muharrem Lloçi për veprën penale "Kultivimi i bimëve narkotike" të parashikuar nga neni 284/1 të K.Penal dhe në bazë të kësaj dispozite, dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim.

Në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale të pandehurit Indrit Muharrem Lloçi, i ulet 1/3 e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 2 (dy) vjet burgim.

Në zbatim të nenit 59 të K.Penal urdhërohet:

Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

Vënia në provë e të dënuarit Indrit Muharrem Lloçi për një periudhë kohe prej 4 (katër) vjet, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale dhe të mos shoqërohet me persona të dënuar.

Gjatë kohës së provës, i dënuari Indrit Muharrem Lloçi të mbajë kontakte me

Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës të vendbanimit të tij.

Heqjen e masës së sigurimit "Arrest në shtëpi" të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale dhëne me vendimin Nr. 1629 Akti, datë 19.09.2021 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në lidhje me provat materiale të veprës si vijon:

Radio e markës "Motorola" me nr. serial në trup 018TMCK411 si dhe karikuesi i saj i markës "Motorola, të sekuestruara me Procesverbalin "Për sekuestrimin e provave materiale" datë 17.09.2021, t'i kthehet të pandehurit Indrit Lloçi.

Telefoni i markës "Samsung" i sekuestruar me Procesverbalin "Për sekuestrimin e provave materiale" datë 17.09.2021, t'i kthehet të pandehurit Indrit Lloçi.

Shpenzimet procedurale të fazës së hetimeve paraprake si dhe shpenzimet gjyqësore, në ngarkim të të pandehurit.

Kundër vendimit mund të bëhet ankim nga palët brenda 15 (pesëmbëdhjete) ditëve në Gjykatën e Apelit Tirane duke filluar ky afat nga e nesërmja e komunikimit të vendimit.

U shpall në Tirane, sot më datë 28.06.2022.

SEKRETARE GJYQËTAR

ORNELA BALLA

ARTAN GJERMËNI

Shpenzime gjyqësore:

Njoftime 1 copë x 150.00 Lekë - 150.00 Lekë

Shpenzime të Prokurorisë - 48 000. 00 Lekë